

SHTOJCA 1

INVENTARI EKZISTUES I AKTIVEVE

SHTOJCA 2

PENALITETET PËR MOSPËRMBUSHJE TË DETYRIMEVE NGA SHOQËRIA KONCESIONARE DHE AUTORITETI KONTRAKTUES

1. Penalitetet për Mospërbushje të Detyrimeve të Punimeve të Rehabilitimit nga Shoqëria Koncesionare

Penaliteti për mospërbushje të ndonjë Detyrimi Rehabilitimi do të llogaritet si produkti i penalitetit të zbatueshëm mbi bazë ditore të mospërbushjes në tabelën më poshtë për këtë Detyrim Rehabilitimi dhe periudhën e mospërbushjes të matur në ditë nga Data e Kërkuar e Detyrimit, në bazë të ndonjë shtyrjeje të lejuar të kësaj date sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë pa kufizim, Raste të një Force Madhore.

Tabela 1

Detyrimi i Shoqërise Koncesionare	Data e Kërkuar e Detyrimit	Penaliteti për mospërbushje, mbi bazë ditore
Neni 6.3	Brenda datës së përcaktuar në Nenin 6.3 (a) të kësaj Kontrate	10,000 (dhjetë mijë) lekë

2. Penalitetet për Mospërbushje të Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues

Tabela 2

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues	Data e Kërkuar e Detyrimit	Penaliteti për mospërbushje, mbi bazë ditore deri në 360 ditë
Neni 2.3	Pas parashkrimit/mbarimit të afateve ligjore dhe administrative	10,000 (dhjetë mijë) lekë
Neni 5.2 (c)	Jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Shoqëria Koncesionare	10,000 (dhjetë mijë) lekë
Neni 5.2 (l)	Në Datën e Hyrjes në Fuqi të Kontratës	10,000 (dhjetë mijë) lekë
Neni 5.2	Në momentin e mospërbushjes së detyrimit	10,000 (dhjetë mijë) lekë

SHTOJCA 3

METODA E PËRLLOGARITJES SË TARIFËS SË SHFRYTEZIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË HEKURUDHËS

Tarifa e shfrytëzimit nga Transportuesit Hekurudhorë të Infrastrukturës Hekurudhore, bazohet në koston e shërbimeve bazë të ofruara nga Administruesi i Infrastrukturës, paketa e të cilave ofron :

- Të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit të dhënë;
- Shfrytëzimin e ndërrueseve të binarëve dhe nyjeve hekurudhore;
- Pritjen, nisjen, komunikimin dhe monitorimin e lëvizjes së tij brenda hapësirës koncesionare;
- Gjithë informacionin tjetër për zbatimin apo operimin e shërbimeve për të cilat është dhënë kapacitet;

Formula e llogaritjes së tarifës së shfrytëzimit të infrastruktures

$$T = \{(N_k * P_k) + (N_r * P_r)\} * C_{\text{mall}} * K * F$$

T	tarifa shfrytëzimit për itinerarin e shpërndarë të trenit
N_k	numri i tren km të përshkruar në linjat kryesore hekurudhore
P_k	koeficienti i rëndësisë për vijat kryesore hekurudhore
N_r	numri i tren km të përshkruar në linjat rajonale hekurudhore
P_r	koeficienti i rëndësisë për vijat kryesore hekurudhore
C_{mall}	Çmimi njësi bazë në njësi monetare për tren/km per trenat e mallrave
K	koeficienti i amortizimit të shinave
F	koeficienti, që shpreh kërkesat e transportuesve në lidhje me orarin

Tarifa e shfrytëzimit përcaktohet për çdo itinerar treni.

Vlerat e elementëve të veçantë të formulës për llogaritjen e tarifës së shfrytëzimit do të merret nga tabelat e mëposhtme

Koeficientët e rëndësisë – P

- Vijat hekurudhore kryesore	1.35
- Vije rajonale	1.00

Koeficientët e amortizimit të shinave – K

- Trenat e mallrave (mbi 2000 bruto)	1.50
- Trenat e mallrave (1000 ton bruto deri ne 2000 ton bruto)	1.20
- Trenat e mallrave (700 ton bruto deri ne 1000 ton bruto)	1,00
- Trenat e mallrave (më pak se 700 ton bruto)	0.80
- Trena (500 ton deri ne 1000 ton)	0.50
- Trena me pak se 200 ton bruto	0,35

Faktori për kërkesën e Transportuesit Hekurudhor në lidhje me orarin – F

- Itinerarët e shpërndarë të trenave, të kërkuar para hyrjes së fuqi të orarit	1
- Itinerarët e shpërndarë të trenave mbi bazën e kërkesave ad hoc	1,2

Çmimi i shërbimeve të tjera mbi paketën bazë

Një listë me shërbimet e tjera do të publikohet në Deklaratën e Rrjetit.

SHTOJCA 4

INXHINIERI I PAVARUR

Inxhinieri i pavarur vlerëson përputhshmërinë dhe progresin e punimeve të rehabilitimit në përputhje me këtë Kontratë. Inxhinieri i Pavarur i raporton çdo tre muaj Autoritetit Kontraktor. Shoqëria Koncesionare siguron në kohën e duhur informacionin teknik të kërkuar nga Inxhinieri i Pavarur, kur ky i fundit e kërkon një informacion të tillë për arsye të kryerjes së detyrave të tij /saj.

Shoqëria Koncesionare i mundëson akses Inxhinierit të Pavarur në Zonën e Koncesionit, siç gjykohet e përshtatshme për kryerjen e detyrave të tij.

Detyrat Specifike të Inxhinierit të Pavarur

Detyrat e Inxhinierit të Pavarur përfshijnë sa më poshtë:

- Monitorimin dhe raportimin e punimeve inxhinierike dhe rehabilituese në përputhje me këtë Kontratë, të projekteve dhe punimeve të përfunduara për sa i përket Detyrimeve të Rehabilitimit;
- Ofrimin e konsulencës teknike të nevojshme në lidhje me miratimet ligjore të kërkuara prej Shoqëria Koncesionaret nga Autoriteti Kontraktues dhe subjektet e tjera shtetërore jashtë zonës së Koncesionit;
- Ofrimin e konsulencës teknike të nevojshme në lidhje me miratimet e licencimit të kërkuara nga Shoqëria Koncesionare, duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të kopjeve të raporteve përkatëse të përgatitura nga Inxhinieri i Pavarur për ato subjekte shtetërore përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve;
- Monitorimin e Programit të rënë dakord dhe progresin e punimeve të përfunduara në lidhje me Detyrimet e Rehabilitimit;
- Lëshimin e Certifikatës së Përfundimit të Punimeve pas përmbushjes së mjaftueshme të secilit prej Detyrimeve të Rehabilitimit në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate;
- Ofrimin e konsulencës teknike për Shoqëria Koncesionaren në lidhje me ndërmjetësimin me subjektet shtetërore;
- Vlerësimin dhe këshillimin në lidhje me miratimin e ndryshimeve të punimeve dhe kërkesave shtesë të paspecifikuara shprehimisht në këtë Kontratë, nëse kërkohet;
- Monitorimin e përfundimit të punimeve dhe sistemeve, duke përfshirë edhe miratimin e finalizimit të projekteve dhe manualeve të ndërtimit;
- Monitorimin e punimeve të ndërtimit në progres, për të garantuar përputhshmërinë me rregulloret e sigurimit teknik nga zjarri;

SHTOJCA 5

FORMA E PROCESVERBALIT NGA AUTORITETI KONTRAKTUES DHE SHOQËRIA KONCESIONARE QË KONFIRMON MARRJEN NË DORËZIM TË AKTIVEVE EKZISTUESE

Tiranë, [●] 201X

1. I referohemi Kontratës së Koncesionit ("**Kontrata e Koncesionit**") të lidhur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në Republikën e Shqipërisë ("**Autoriteti Kontraktues**"), dhe Shoqëria Koncesionare ALBRIL sh.p.k ("**Shoqëria Koncesionare**") më 01.02.2016.
2. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë kuptimin që iu janë dhënë në Kontratën e Koncesionit.
3. Sipas Kontratës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare konfirmon që (i) Aktivet ekzistojnë; (ii) janë të lirë nga ndonjë Okupim, Interes Sigurimi, detyrim, qera, barrë dhe të drejta të tjera të ushtrueshme nga palë të treta; (ii) situata faktike përkon me kushtet dhe pershkrimin e Shtojcës 1.
4. Me anë të këtij procesverbali konfirmohet nga Palët marrja në dorëzim e aktiviteteve ekzistuese sipas listës bashkëlidhur pas verifikimit sipas paragrafit 3 të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Nga: _____

Emri: _____

Pozicioni: _____

SHOQËRIA KONCESIONARE ALBRIL SHPK

Nga: _____

Emri: _____

Pozicioni: _____

SHTOJCA 6

AUTORIZIMET

1. Autorizimet

- (A) Miratimi i Lejes së Zhvillimit/Ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit përfshi miratimin e lejeve dytësore pjesë përbërëse e këtij aplikimi dhe lëshimi i Lejes së Ndërtimit nga Agjensia e Zhvillimit të Territorit.
- (B) Aprovimi i Lejeve për operimin e Hekurrudhës që përfshin Leje Veprimtarie: *(Koncesionarit i njihet e drejta për të ofruar shërbime të transportit hekurudhor të mallrave dhe/ose udhëtarëve dhe bagazheve ku kriteret e pashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore).*
- (C) Cdo leje/autorizim/license që kërkohet sipas Ligjit të Zbatueshëm për ushtrimin e veprimtarisë nga Shoqëria Koncesionare.

2. Autorizimet për Përdoruesit e tjerë të Hekurrudhës apo aktivitete të tjera të Shoqëria Koncesionaret

Shoqëria Koncesionare mund të kontraktojë me të tretët për ofrimin e shërbimeve në përputhje me këtë Kontratë, Ligjin e Zbatueshëm dhe Konventat, subjekt të palëve të tilla të cilat nuk veprojnë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë, Ligjin e Zbatueshëm dhe, nëse aplikohet, Konventat.

SHTOJCA 7

ZONA E KONCESIONIT

Zona e Koncesionit përfshin Inventarin e Pasurive të Paluajtshme sipas Shtojcës 1 dhe i kalon në administrim dhe përdorim në favor të Shoqërisë Koncesionare.

Këto zona tregohen si një zonë e unifikuar, skicë e cila është përvijuar në Planin 1 bashkëngjitur kësaj Shtojce. Stacionet e Hekurudhës fillojnë nga Km 84,100 në Stacionin Hekurudhor Fier deri në Stacionin Hekurudhor Vlorë në KM 119,370 dhe në Stacionin Hekurudhor Ballsh në Km 110,500 dhe përfshijnë të gjitha degëzimet dytësore të treguara në hartat bashkëlidhur.

SHTOJCA 8

OFERTA

STUDIMI I FIZIBILITETIT

Studimi i Fizibilitetit përfshin pa kufizim sa më poshtë vijon:

Studimi i Fizibilitetit Linja Fier – Vlorë

❖ Superstruktura (Traversat, shinat, aksesorët lidhës, traseja ballasti)

Per ta kthyer linjen hekurudhore në gjendje për të siguruar një lëvizje të pandërprerë dhe të sigurtë të mjeteve hekurudhore me shpejtësi deri në 50 km/ore për trenat e mallrave dhe 60 km/ore për trenat e pasagjerëve, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme :

- Zëvendësimi imediat me traversa të reja, i të gjithë traversave të drurit të cilat tashmë rezultojnë të kalbura vlerësuar në sasinë e 12,754 copeve, si dhe pjesa tjetër e traversave të drurit prej 24,454 copë, e dëmtuar në masën 50%, Sasia totale e traversave me dimensionet e kërkuara 2.6 m x 0,26 m x 0,16 m të ndërruara do të shkojë në total në 37,208 copë. Kjo sasi parashikohet të rritet edhe si rezultat edhe i rehabilitimit të linjës drejt azotikut si dhe rindërtimit të linjës që shkon drejt rafinerisë së naftës Fier.
- Traversat e drurit do të jenë ahu ose lisi dhe të imprenjara sipas STAZH Shqiptar. Në përlllogaritje tona është marrë parasysh që sasia e traversave për një km linjë hekurudhore në vijë të drejtë të jetë 1,440 copë dhe 1600 copë në vijë të drejtë, por me një pjerrësi 9‰, apo në kthesa hekurudhore me rreze më të vogël se 600m.
- Traversat e ndërrueseve gjithashtu do të jenë po prej druri të imprenjuara sipas STAZH Shqiptar me gjatësi nga 2.6 deri në 4.2 metra, sipas projektit të ndërtimit të ndërrueseve.
- Ndërimi i të gjithë shinave S-49 të kthesave me gjatësi 5.028 km, me rreze nga 500 m deri 600 m me shina të reja të po këtij tipi.
- Gjatësia e shinave të reja do të jetë mbi 12.5 metra dhe gjatësia e përdorimit të tyre në linjë, do të kushtëzohet nga mundësia praktike e transportit të tyre. Vendosja e shinave 25 metra është një avantazh pasi ato janë më të preferueshme kur vendosen në kthesa me rreze të vogla, por sic e përmenden me lart përdorimi i tyre do të jetë në funksion të mundësisë të transportit.
- Në urat hekurudhore me gjatësi mbi 30 metra duhet të vendosen kundrashina. Kundrashinat do të jenë te tipit S-49 të cilat do të hiqen nga kthesat.
- Në ato pjesë të trasëse me mure mbajtëse me lartësi mbi 3 metra do të vendosen kundrashina në pjesën e brendshme të krahut të kthesës.
- Do të vendosen kundrashina në kthesa me reze 300.
- Shinat S-49 të hequra nga linja do të përdoren si kundrashina në kthesat me reze 500 dhe 800 metra.
- Zëvendësimi i të gjithë elementëve lidhës dhe bashkues që mungojnë në linjën hekurudhore si pllaka lidhëse, pllaka shtruese, bullona lidhës, trifone hekurudhore.
- Ndrrueset e stacioneve në linjën hekurudhore në këtë segment do të jenë të tilla që të lejojnë një shpejtësi të lëvizjes së trenave në kthesë $V = 2.91 \times$ (rrenja katrore e rezes kthesës ndërruese - 190 m). Ndërrueset e stacioneve në linjën hekurudhore Fier – Vlorë do të jenë me rreze të kthesës të ndrrues 190 m të tipit 1:9.
- Ndrrueseve hekurudhore të cilat kanë konsum të majave të gilperave dhe të zemrave të tyre do ti ndrohen këto elemente. Po kështu në të gjitha ndrrueset do të vendosen traversa druri speciale të reja.

- Gjerësia e prizmit të ballastit në pjesën e bazës së sipërme do të jetë 3m, lartësia e përgjithshme e mbushjes 35cm. Suprina e ballastit do të realizohet 3 cm më poshtë se plani i sipërm i traverses, kritere këto në përputhje të plotë me Kushtet Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të linjave hekurudhore.
- Mbishtresa hekurudhore do të ndërtohet sipas normativave të projektimit të miratuara për ndërtim e hekurudhave të kategorisë të parë.
- Mbas avancimit të kompletimeve të mësipërme do bëhen punime të ngritjes, drejtimit dhe nivelimit të linjës hekurudhore.
- Në kthesat me reze të vogla të linjës hekurudhore mbas përfundimit të ndërtimit të tyre do të bëhet piketimi i tyre duke vendosur treguesit gjeometrike të kthesës si dhe piketat kontrolluese të aksit të linjës hekurudhore.
- Në të gjithë gjatësinë e linjës hekurudhore në krahun e djathtë të saj, në drejtim të rritjes së kilometrazhit, në largësi jo më të vogël se 2m nga shina, do të vendosen treguesit e pendencave të linjës hekurudhore ku të shënohet pendenca dhe gjatësia e saj si dhe tabelat e sirenave në afërsi të kalesave hekurudhore.
- Trupi i trasës në rastin e trasës në mbushje në pjesën e sipërme të tij do të zgjerohet deri në gjerësinë 5.5 metra. Ky zgjerim do të bëhet duke përdorur ballastin e keq që ndodhet në linjë, i cili në momentin që do të zmontohej linjë hekurudhore do të largohet për të lejuar hedhjen e ballastit të ri të cakullit.
- Pjerrësia e skarpates të prizmit të ballastit të cakullit do të 1 :1,25. Në vende ku skarpata e trasës hekurudhore nuk do rezultojë sipas kushtit të përcaktuar do të bëhet plotësimi i saj me material.
- Në ato vende ku linja është në usek do të bëhen punime për kullimn e ujrave duke hapur kanale kullues gjatë gjithë gjatësisë të usekut nga të dy anët e tij.
- Në kuotën e sipërme të faqes të skarpatës, në cep të saj, do të vendosen guret kilometrike çdo 100 metra.

Veprat e artit

- Në urën rrugore – hekurudhore të Mifolit do të bëhet përforcimi i themeleve të këmbëse të urës si dhe mbrojtja e shpatullave dhe skarpatave të trasës nga prurjet e lumit të Vjosës, në fillim dhe në fund të urës.
- Tuneli i Koshevicës do të bëhet me ndricim si dhe do të bëhet pastrimi i kanaleve të tij anësor për disiplinimin dhe kullimin e ujrave të tunelit. Në hyrje dhe dalje të tunelit të Koshevicës do të bëhen punime bonifikuese për kullimin e ujrave. Në dalje të tunelit të Koshevicës në drejtim të Levanit. Nga km 88.400 deri në km 89.200 do të bëhet zhbllokimi i kanaleve kulluese.
- Në viaduktin në dalje të stacionit të Levanit do të ndërtohen parapetet për të mos lejuar rënjen e cakullit të linjës si dhe do të riparohen të gjithë parmaket në gjithë gjatësinë e viaduktit.
- Në tombinot hekurudhore do të bëhet pastrimi i tyre nga prurjet e ngurta të cilat i kanë bllokuar ato.

- Në të gjitha urat dhe mbikalimet e gjata do të vendosen traversa druri hekurudhore të cilat përdoren në urat hekurudhore.

Stacionet hekurudhore

➤ Stacioni Levan

Godina e stacionit të Levanit është totalisht jashtë funksionit. Po kështu edhe linjat hekurudhore të tij janë jashtë funksionit dhe qëllimit për të cilin janë ndërtuar. Stacioni i Levanit që fillon në km 93.700 dhe përfundon në km 94.300 është afër stacionit të Fierit km 85.500 nuk do të përdoret si stacion dhe superstruktura e tij do të kthehet në atë të linjës hekurudhore njëfishe. Elementët përbërës të linjës hekurudhore, ndrruese dhe shina të linjave të dyta do të përdoren sërishmi.

➤ Stacioni Novosele

Godina e stacionit të Novoselës gjithashtu është jashtë funksionit, kurse linjat e dyta të stacionit së bashku me ndrruset nuk ekzistojnë. Stacioni i Novoseles fillon në km 100,250 dhe përfundon në km 100,750. Duke vlerësuar numrin e banorëve të zones të Novoselës dhe pozicionin kilometrik të tij, Në këtë stacion do të bëhet edhe rikonstruksioni i godinës të stacionit si dhe i platformes të hyrjes dhe zbritjes të pasagjerëve si dhe një linjë të dytë me gjatësi të shfrytëzueshme prej 350 metra së bashku me dy ndrruese. Në këtë stacion do të bëhet kryqëzimi i trenave si në drejtimin Fier – Vlorë ashtu dhe anasjelltas. Ky stacion i kryqëzimit të trenave do të rritë aftësinë lëshuese të mallrave dhe të udhëtarëve të stacioneve Fier dhe Vlorë dhe të gjithë segmentit hekurudhor (Fleta e projektit S-6 Stacioni Novosele).

➤ Stacioni Skrofotinë

Stacioni i Skrofotines fillon në Km 105,770 dhe përfundon në km 106,500. Duke patur parasysh aktivitetin tregtar të zonës për prodhimin e kripës, si dhe kërkesën në të ardhmen për ta eksportuar atë, do ishte e udhës që të ndërtohej një degëzim prej 900metrash, por një gje e tillë për momentin është e pamundur për shkak të prishjes së degëzimit nga intersektimi i autostratës Fier Vlorë.

➤ Stacioni Vlorë

Stacion i Vlorës është i përbërë nga stacioni i pasagjerëve dhe ai i mallrave i cili fillon në km 116,150 dhe përfundon në km 117,070. Në hyrje të stacionit të mallrave të Vlorës është një lidhje hekurudhore degëzim i rrjetit hekurudhor kombëtar që përfundon në stacionin e petroliferës. Kjo lidhje hekurudhore aktualisht është në gjendje pune, por i mungon ndërruesja. Gjithashtu këtij stacioni do ti bëhet rikonstruksion i godinës (Fleta e projektit S-3 Stacioni Vlorë).

Në ambjentet e stacionit të udhëtarëve Vlorë do të bëhen punime për rikonstruksionin e ambjenteve si të qendrimit të udhëtarëve ashtu edhe të personelit administrativ dhe të lëvizjes.

Në linjat hekurudhore të stacionit të udhëtarëve Vlorë momentalisht kryhet i gjithë procesi i manovrës, si dhe të pranim – nisjes të trenave, por në vitet në vijim duhet të bëhen ndërhyrje në rradhë të parë në ndrruset hekurudhore të këtij stacioni.

Në të gjithë stacionet hekurudhore, fundore apo të ndërmjetëm, si dhe në hyrje e po ashtu në daljen, do të vendosen treguesit dhe shenjat e linjës hekurudhore që tregojnë karakteristikat gjeometrike, metrike dhe kilometrike të linjës hekurudhore, si dhe sinjalistika e nevojshme që tregon fillimin,

hyrjen dhe daljen nga stacionet, siç parashikohet në Rregulloren e Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhës.

Në të gjithë stacionet hekurudhore do të montohen pajisje alternative për prodhim energjie elektrike në rast të mungesës të energjisë nga rrjeti kombëtar.

Në të gjithë stacionet hekurudhore si dhe në sheshet ku do të bëhet manovra apo formimi i trenave do të bëhet ndricimi i tyre.

Në të gjithë stacionet do të vendosen shtyllat e kontrollit të ndrrueseve dhe shtyllat e kufirit të manovrës të trenave.

Në të gjithë stacionet hekurudhore do të montohen kamera sigurie vëzhguese të cilat do të integrohen në sistemin qendror të vëzhgimit dhe të kontrollit që do të instalohet.

■ Kalesat hekurudhore

Godinat e kalesave hekurudhore do të rikonstruktohen. Në to do të vendosen pajisje elektro – mekanike të tipit hekurudhor të mbrojtjes të trenit gjatë kalimit të tij në këto vende me elementë përbërës :

- Një hekur çeliku shtylle me diamter 140 mm, i cili është fiksuar në një bazamet prej betoni.
- Kutia e manovrës ku montohen krahët e krahut prej alumini antikoroziv të cilët ulen dhe ngrihen nëpërmjet kësaj kutie të manovrës.
- Kutia e manovrës përbëhet nga motorri elektrik, si pajisja që bën manovren me dorë.
- Krahët e prej alumini të cilët ulen dhe ngrihen nga pozicioni 0 në pozicion vertikal 90 gradë nëpërmjet motorit.
- Dy sinjale të kuq.
- Një sinjal akustik i cili fillon të bjere kur sinjalet e kuq fillojnë të aktivizohen dhe pushon në momentin kur krahët janë të ulur.
- Një tabelë ku është shkruar STOP me ngjyrë të kuqe.

Në këto kalesa do të vendosen tabelat florishente paralajmëruese për drejtuesit e automjeteve ashtu siç përcaktohet në Kodin Rrugor, si dhe vendoset mekanizmi i bllokimit të mjeteve auto në kohën e kalimit të trenave. Në kalesat hekurudhore do të montohen kabinat e qëndrimit të ruajtësit të kalesave, në të cilat do të montohen kamerat vëzhguese të sigurisë, sistemi i telekomunikimit të tyre me stacionet hekurudhore dhe me lokomotivat, si dhe këto kalesa do të jenë të ndriçuara. Rruga e cila intersekon linjen hekurudhore do të rikonstruktohet sipas kushteve teknike të ndërtimit të kalesave hekurudhore ku mund të përmendim vendosjen e kundrashinave në të dy anët e shinave, rruga në kalimet në nivel do të jetë në të dy anët e saj në një nivel, në distancë 10 metra nga aksi i linjës hekurudhore dhe më tej do lejohet të jetë e pjerrët me pendencë 1 për qind.

Për zgjidhjen e problemit të kalimeve hekurudhore të paligjshme do të bashkëpunohet me Pushtetin Lokal për të gjetur zgjidhje oportune nga të dy palët duke ndërtuar rruge paralele me hekurudhen duke eliminuar kalimet hekurudhore të paligjshme.

■ Sistemi i telekomunikimit për levizjen dhe kontrollin e trenave

Për të kryer lëvizjen e pandërprerë dhe të sigurtë të trenave do të instalohet një sistem i telekomunikimit i cili do të realizojë një ndërlidhje të pandërprerë 24 orëshe midis personelit të stacioneve hekurudhor, makinistëve si dhe specialistëve të sektorit të mirëmbajtjes të linjës hekurudhore dhe atyre të manovrës nëpër stacione.

Ky sistem do të integrohet në sistemin e Radio Komunikimit të Rrjetit Hekurudhor Shqiptar.

Sistemi i telekomunikimit do të realizohet me regjistrim të bisedave telefonike dhe do të jetë i licensuar nga Organet Përkatëse.

I gjithë aktiviteti i transportit hekurudhor në stacionet hekurudhore Fier, Vlorë, Novosele dhe në kalimet në nivel do të jetë i monitoruar me kamera vëzhgimi nga një qendër kontrolli

Sistemi i telekomunikimit dhe ai i vëzhgimit me kamere do të vendoset në të gjithë lokomotivat.

Studimi i Fizibilitetit Linja Fier – Ballsh

❖ Superstruktura (Traversat, shinat, aksesoret lidhës, traseja, ballasti)

Për ta kthyer linjën hekurudhore në gjendje për të siguruar nëlëvizje të pandërprerë dhe të sigurtë të mjeteve hekurudhore për një shpejtësi të lëvizjes të trenave deri në 50 km/orë për trenat e mallrave dhe 60 m/orë për trenat e pasagjerëve, do të ndërmerren veprimet e mëposhtme :

- Zëvendësimi i të gjithë traversave të drurit të kalbura me traversa të tjera. Traversat e drurit do të jenë me dimensionet e kërkuara 2.6 m x 0,26 m x 0,16 m dhe një pjesë e mirë do të jenë nga traversat e pakonsumuara të trasës Fier – Vlorë, si dhe gjithashtu do shikohet mundësia e travesave të betonit që do rezultojnë nga zëvendësimi i segmentit tjetër. Në përlogaritje tona është marrë parasysh që sasia e traversave për një km linje hekurudhore në vijë të drejtë të jetë 1,440 copë dhe 1600 copë në vijë të drejtë, por me një pjerrësi 9‰, apo në kthesa hekurudhore me rreze me të vogël se 600m.
- Traversat e ndërruese janë prej druri të imprenjuara sipas STAZH Shqiptar me gjatësi nga 2.6 deri në 4.2 metra, sipas projektit të ndërtimit të ndërrueseve.
- Ndërimi i të gjithë shinave P - 43 të kthesave me rreze nga 300 m deri 500 m me shina të reja të po këtij tipi.
- Gjatësia e shinave të reja do të jetë mbi 12.5 metra dhe gjatësia e përdorimit të tyre në linjë, do të kushtëzohet nga mundësia praktike e transportit të tyre.
- Ndërimi i ballastit të zhavorrit me ballast cakull në segmentin Fier – Ballsh.
- Gjerësia e prizmit të ballastit në pjesën e bazës së sipërme do të jetë 3m, lartësia e përgjithshme e mbushjes 35cm. Suprina e ballastit do të realizohet 3 cm më poshtë se plani i sipërm i traversës, kritere këto në përputhje të plotë me Kushtet Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të linjave hekurudhore.
- Mbishtresa hekurudhore do të ndërtohet sipas normativave të projektimit të miratuara për ndërtimin e hekurudhave të kategorisë të parë.
- Zëvendësimi i të gjithë elementëve lidhës dhe bashkues që mungojnë në linjën hekurudhore si pllaka lidhëse, pllaka shtruese, bullona lidhës, gozhdë hekurudhore.
- Në urat hekurudhore me gjatësi mbi 30 metra duhet të vendosen kundrashina. Kundrashinat do të jenë të tipit P - 43 të cilat do të hiqen nga kthesat.

- Do të vendosen kundrashina në kthesa me reze 300.
- Shinat P-43 të hequra nga linja do të përdoren si kundrashina në kthesat me rreze 300 dhe 500 metra.
- Ndrueset e stacioneve në linjën hekurudhore Fier – Ballsh do të jenë të tilla që të lejojnë një shpejtesi të lëvizjes së trenave në kthese $V = 2.91 \times$ (rrenja katrore e rezes kthesës ndruses -190 m). Ndërrueset e stacioneve në linjën hekurudhore Fier – Ballsh duhet të jenë me reze të kthesës të ndërrueses 190 m të tipit 1: 9.
- Ndrueseve hekurudhore të cilat kanë konsum të majave të gjilperave dhe të zemrave të tyre do ti ndërrohen këto elementë. Po kështu në të gjitha ndrrueset do të vendosen traversa druri speciale të reja.
- Mbas kryerjes së kompletimeve të mësipërme do bëhen punimet e ngritjes, drejtimit dhe nivelimit të linjës hekurudhore.
- Në kthesat me rreze të vogla të linjes hekurudhore mbas përfundimit të ndërtimit të tyre do të bëhet piketimi i tyre duke vendosur treguesit gjeometrike të kthesës si dhe piketat kontrolluese të aksit të linjës hekurudhore.
- Në të gjithë gjatësinë e linjes hekurudhore në krahun e djathtë të saj, në drejtim të rritjes së kilometrazhit, në largësi jo më të vogël se 2m nga shina, do të vendosen treguesit e pendencave të linjës hekurudhore ku të shënohet pendenca dhe gjatësia e saj si dhe tabelat e sirenave në afërsi të kalesave hekurudhore.
- Trupi i trasësë në rastin e trasësë me mbushje në pjesën e sipërme të tij do të zgjerohet deri në gjerësinë 5.5 metra. Ky zgjerim do të bëhet duke përdorur ballastin e keq që ndodhet në linjë, i cili në momentin që do të zmontohej linjë hekurudhore do të largohet për të lejuar hedhjen e ballastit të ri të cakullit.
- Në vende ku skarpata e trasësë hekurudhore nuk është sipas pjerrësisë 2/3 do të bëhet plotësimi i saj me materjal.
- Në ato vende ku linja është në usek do të bëhen punime për kullimin e ujrave duke hapur kanale kullues gjatë gjithë gjatësisë të usekut nga të dy anët e tij.
- Në kuotën e sipërme të faqes të skarpatës, në cep të saj, do të vendosen guret kilometrike çdo 100 metra.

Veprat e artit

- Do të rindërtohen pritrat lumore të cilat janë të shkatërruar pasi në këto pika në periudhë të rreshjeve linja hekurudhore rrezikohet të bllokohet gjë që mund të sjellë bllokim të trafikut të lëvizjes së trenave.
- Do të rindërtohen pritrat malore të cilat janë të dëmtuara dhe që paraqesin rrezik jo vetëm për bllokim të trafikut por edhe dëmtim të mjeteve të transportit në momentin e shkarjeve të dherave.
- Në tombinot hekurudhore do të bëhet pastrimi i tyre nga prurjet e ngurta të cilat i kanë bllokuar ato.
- Në një periudhë të mevonshme do të rishikohet rikonstrukcioni i tombinove hekurudhore të cilat rezultojnë aktualisht me diametër të vogël dhe kërkojnë zëvendësimin e tyre me tombino me diametër më të madh për të përballuar prurjet.
- Në të gjitha urat dhe mbikalimet e gjata do të vendosen traversa druri hekurudhore të cilat përdoren në urat hekurudhore.

- Në të gjithë urat e gjata do të vendosen parmake.

Stacionet hekurudhore

A. Stacioni Fier

Stacioni i Fierit është i përbërë nga stacioni i pasagjerëve dhe ai i mallrave. Në godinën dhe ambientet e stacionit të udhëtarëve Fier do të bëhen punime për rikonstruksionin e ambjentëve si të qëndrimit të udhëtarëve ashtu edhe të personelit administrativ dhe të lëvizjes.

Stacioni i Fierit fillon në km 84, 100 dhe përfundon në km 85,500. Për fillimin e punës të transportit si të udhëtarëve ashtu edhe të mallrave nga Ballshi dhe Vlora për në drejtim të Fierit linjat hekurudhore të këtij stacioni nuk paraqesin probleme por për të patur një vijueshmëri të punës pa probleme në të ardhmen do të bëhen punime në këto linja për të realizuar ndërrimin e traversave si në linjë edhe në ndrrueset e këtij stacioni, duke planifikuar të ketë një post ndërruesi të degëzimit hekurudhor që do lidhi stacionin e mallrave Fier me degëzimin e ri në drejtim të ish azotikut, si dhe një tjetër që do të ndajë linjën hekurudhore për në drejtimin e Ballshit apo të Vlorës. Stacioni do të ndricohet dhe do vendosen elementët e parashikuar të sigurisë në Kodin Hekurudhor.

B. Stacioni Krapis

Stacioni i Krapisit fillon në km 91,800 dhe përfundon në km 92,300. Ky stacion duke qenë se është shumë afër me stacionin e Fierit, gjatësinë relativisht të shkurtër së linjës vetëm 24.5km, shkatërrimit totalisht të linjës dytësore, ndërruesave, godinës dhe ambientit të tij, është menduar të mos vendoset me në funksion.

C. Stacioni Kasnicë

Stacioni i Kasnicës fillon në km 99,250 dhe përfundon në km 99.700. Duke patur parasysh që linja hekurudhore Fier – Ballsh është 24.5 km, është me se ekonomike që midis Fierit dhe Ballshit të jetë vetëm një stacion për shkëmbimin e trenave dhe ky të jetë ai i Kasnicës. Zgjedhja është bërë për shkak se stacioni i Kasnicës është në mes të linjës Fier Ballsh.

Ne stacion do të rindërtohet një linjë e dytë e kryqëzimit të trenave me gjatësi të shfrytëzimit të tyre 350 metra, së bashku me dy ndruse. Stacioni do të ndriçohet dhe do vendosen elementët e parashikuar të sigurisë në Kodin Hekurudhor (Fleta projektit S-5 Stacioni Kasnicë).

D. Stacioni Ballsh

Stacioni Ballsh fillon në km 108,500 dhe përfundon në km 110,000. Gjithashtu këtij stacioni do ti bëhet rikonstruksion i godinës. Në ambjentet e stacionit të udhëtarëve Ballsh do të bëhen punime për rikonstruksionin e ambjentëve si të qëndrimit të udhëtarëve ashtu edhe të personelit administrativ dhe të lëvizjes. Në këtë stacion do të rehabilitohen linjat e dyta të tij për manovren e trenave në stacion si dhe do realizohet rilidhja hekurudhore me Kombinatin e përpunimit të thellë të naftës, pasi i ka në gjendje teknike të degraduar (Fleta projektit S-4 Stacioni Ballsh).

Në të gjithë stacionet hekurudhore, fundore apo të ndërmjetëm, si dhe në hyrje e po ashtu në daljen, do të vendosen treguesit dhe shenjat e linjës hekurudhore që tregojnë karakteristikat gjeometrike, metrike dhe kilometrike të linjës hekurudhore, si dhe sinjalistika e nevojshme që tregon fillimin, hyrjen dhe daljen nga stacionet, siç parashikohet në Rregulloren e Shfrytëzimit Teknik të Hekurudhës.

Në të gjithë stacionet do të vendosen shtyllat e kontrollit të ndruseve dhe shtyllat e kufirit të manovrës së trenave.

Në të gjithë stacionet hekurudhore do të montohen pajisje alternative për prodhim energjie

Në të gjithë stacionet hekurudhore si dhe në sheshet ku do të bëhet manovra apo formimi i trenave do të bëhet ndricimi i tyre.

Në të gjithë stacionet hekurudhore do të montohen kamera sigurie vëzhguese të cilat do të integrohen në sistemin qendror të vëzhgimit dhe të kontrollit që do të instalohet.

❖ *Kalesat hekurudhore*

Godinat e kalesave hekurudhore do të rikonstruktohen. Në to do të vendosen pajisje elektro – mekanike të tipit hekurudhor të mbrojtjes të trenit gjatë kalimit të tij në këto vende me elementë përbërës :

- Një hekur çeliku shtylle me diameter 140 mm, i cili është fiksuar në një bazamet prej betoni.
- Kutia e manovres ku montohen krahët e krahut prej alumini antikoroziv të cilët ulen dhe ngrihen nëpërmjet kësaj kutie të manovrës.
- Kutia e manovrës përbëhet nga motorri elektrik, si pajisja që bën manovrën me dorë.
- Krahët e prej alumin të cilët ulen dhe ngrihen nga pozicioni 0 në pozicion vertikal 90 grade nëpërmjet motorit.
- Dy sinjale të kuq.
- Nj sinjal akustik i cili fillon të bjerë kur sinjalet e kuq fillojnë të aktivizohen dhe pushon në momentin kur krahët jan të ulur.
- Një tabelë ku është shkruar STOP me ngjyrë të kuqe.

Në këto kalesa do të vendosen tabelat florishente paralajmëruese për drejtuesit e automjeteve ashtu sic përcaktohet në Kodin Rrugor, si dhe vendoset mekanizmi i bllokimit të mjeteve auto në kohën e kalimit të trenave. Në kalesat hekurudhore do të montohen kabinat e qendrimit të ruajtësit të kalesave, në të cilat do të montohen kamerat vëzhguese të sigurisë, sistemi i telekomunikimit të tyre me stacionet hekurudhore dhe me lokomotivat, si dhe këto kalesa do të jenë të ndrihuara. Rruga e cila intersekon linjën hekurudhore do të rikonstruktohet sipas kushteve teknike të ndërtimit të kalesave hekurudhore ku mund të përmendim vendosjen e kundrashinave në të dy anët e shinave, rruga në kalimet në nivel do të jetë në të dy anët e saj në një nivel, në distacë 10 metra nga aksi i linjës hekurudhore dhe më tej do lejohet të jetë e pjerrët me pendencë 1 përqind.

Per zgjidhjen e problemit të kalimeve hekurudhore të paligjshme do të bashkëpunohet me Pushtetin Lokal për të gjetur zgjidhje oportune nga të dyja palët duke ndërtuar rrugë paralele me hekurudhen dhe duke eliminuar kalimet hekurudhore të paligjshme.

❖ *Sistemi i telekomunikimit për levizjen dhe kontrollin e trenave*

Për të kryer lëvizjen e pandërprerë dhe të sigurtë të trenave do të instalohet një sistem i telekomunikimit i cili do të realizojë një ndërlidhje të pandërprerë 24 orëshe midis personelit të stacioneve hekurudhorë, makinistëve si dhe specialistëve të sektorit të mirëmbajtjes të linjës hekurudhorë dhe atyre të manovrës nëpër stacione.

Ky sistem do të integrohet në sistemin e Radio Komunikimit të Rrjetit Hekurudhor Shqiptar.

Sistemi i telekomunikimit do të realizohet me rregjistrim të bisedave telefonike dhe do të jetë i liçensuar nga Organet Përkatëse.

I gjithë aktiviteti i transportit hekurudhorë në stacionet hekurudhorë Fier, Vlorë dhe Novoselë dhe në kalimet në nivel do të jetë i monitoruar me kamera vëzhgimi nga një qendër kontrolli.

Sistemi i telekomunikimit dhe ai i vëzhgimit me kamerë do të vendoset në të gjithë lokomotivat.

PLANJAHI KUROR VLORE

1:5000

Vlore-Nenkalin-Novosele

Stacioni Vlore

Stacionet

Fier - Vlore

0 30 60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 1



LINJA E FERROUDHORE

1:5.000

Vlore-Nerkalimi Novosele

Vlore-Nerkalimi Novosele



Stacionet

Kufijte e Linjes



Fier - Vlore



Fier - Ballsh

0 30 60 120 180 240
Meter

Faqe Nr 2



LINJA HEKURUDHORE

1:5,000

Vlore-Nenkallim Novosele

Stacionet Kufijte e l
Fier - Vlore Fj

30 60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 3



LINJAHTKURUDHORE

1:5.000



Stacionet Kufijte e Lin
Fier - Vlore Fier

0 30 60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 4



LINJA HEKURUDHORE

1:5.000

Vlore-Nenkalimi Novosele

Stacionet
Kufijte e Linjes He
Fier - Vlore Fier - Ball

60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 5



LINJA HEKURUDHORE

1:5,000

Vlore Nenkalin i Novosele



Stacionet

Kufijte e Linjes



Fier - Vlore



Fier - E

60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 6



LINJA HEKURUDHORE

1:5.000

Vlore-Nenkallm Novosele



Stacionet



Fier - Vlore

Kufijte e Linjes He



Fier - Balls

60 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 7



LINJA HEKURUDHORE

1:5,000

Vlore-Nenkallimi Novosele

Stacionet Kufijte
Fier - Vlore

0 120 180 240
Meter

Faqe Nr. 8



LINJA HEKURUDHORE

1:5,000

Vlore-Nenkalimi Novosele




Stacionet

Kufijte €



Fier - Vlore



Faqe Nr. 9



LINJA HEKURUDHORE

1:5,000

Vlore-Nenkalimi Novosele



Stacionet

Kufijte e Linje



Fier - Vlore



Fier -

120

180

240

Meter

Faqe Nr. 10



LINJA FIER KURUDHORE

1:5 000

Vlore-Nenkalimi Novosele



Stacionet

Kufijte e Linjes Heku



Fier - Vlore



Fier - Ballsh

120 180 240

Meter

Faqe Nr. 11



